




Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna Drenas
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme



Shkresë	26.05.2020
Nga:	U.D ZPP BLERIM NIKI
Lënda:	Vendim i AK



ËSHTË DERGUAR NJE KERKESË PER RISHQYRTIM NE E PROKURIM PER PROJEKTIN ME NR PROKURIMIT 611-20-008-521, "RREGULLIMI I SHTRATTIT TE LUMIT DRENICA DHE VERBICA"

PYTJA E OPERATORIT EKONOMIK

Të nderuar , ne me datë 21.05.2020 në platformën elektronike të prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku ne jemi shpalluar si tenderues i eliminuar , ndërsa është rekomanduar për kontratë OE N.T "FER PETROLL"

Fillimisht ju sqarojmë se ne jemi OE I përgjegjshëm dhe i plotesojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë andaj arsyet tuaj për eliminimin tonë nuk qëndrojnë për arsyet në vijim:

Ju në arsyen për eliminimin tonë si arsyetim e keni cekur se neve na mungojnë Lista e Stafit Orgjinal dhe Lista e Kontratave origjinale.

Ju sqarojmë se kjo arsye për eliminimin nuk qendron sepse neni 39.8 I RRUOPP-se e parasheh qartë se nëse lista e kontratave të realizuara nuk është dorezuar por janë dorezuar dëshmite(referencat/certifikata e pranimit teknik/kontrata mund të kerkohen informata sqaruese, por ju si AK nuk i keni marrë fare parasysh dispozitat e nenit të lartpermendur, edhe pse ne i kemi ofruar referencat e kryerjes se puneve dhe kontratat e stafit me gjithë CV. Ne i posedojmë edhe listën e kontratave dhe listën e stafit , por qe ka ndodhur një leshim teknik nga ana jonë gjatë ofertimit dhe nuk e kemi bashkengjitur. Mirëpo më e rendesishme është fakti qe janë bashkengjitur dokumentet tjera, si referencat e punëve te kryera ,

kontratat dhe CV e stafit etj, se sa listat , e të cilat mund të deshmohen shumë thjeshtë.

Ju si autoritet kontraktues na keni diskriminuar neve si OE i pergjegjeshem dhe me cmim më të lirë , pasi qe nuk keni kerkuar sqarime shitesë në lidhjen me listën e stafit dhe listën e kontratave të cilat sic e cekem me larte I posedojmë por qe ka ndodhur një leshim teknik nga ana jonë. Andaj duke mos kërkuar sqarime shitesë po shihet qartë diskriminimi që po na behet neve si OE I pergjegjeshem dhe njëkohesisht kemi ofruar cmim me te lire duke mos marr parasysh faktin se me këtë vendim tuajin po e dëmtoni edhe buxhetin e Republikes se Kosoves.

Ju si AK keni rekomanduar për kontratë OE i cili është i papergjegjeshem sepse nuk I plotëson të gjitha kerkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë

OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka permbushur kerkesat mbi mundësite teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 tek kapacitetit teknik professional sepse kërkesë ka qenë: Të paraqiten pajisjet raportet për mjetet-stabilimentet që janë dispozicion tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) Dy eskavator min 10 deri 20 ton për hapje të kanaleve, Dy luge ngarkuese , nje grader dhe dy kamion min 8-10 ton,) ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dy eskavator ku vetem njeri prej tyre e ploteson kete kerkese ndersa tjetri jo , sepse pesha e tij eshte 27 ton, ndersa kerkesa është shumë e qartë që pesha e eskavatorit duhet të jetë 10-20, pra në këtë rast është percaktuar kufiri minimal dhe maksimal i peshës dhe duhet respektuar me rastin e ofertimit .Gjithashtu OE i rekamunduar për kontratë kërkesën për dy kamionë minimum 8-10 ton nuk e plotëson sepse kamionat e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë peshojnë 13 dhe 15 ton , prandaj ky OE është dashur të eliminohet si i papërgjegjshëm . Pra duke u bazuar në sqarimet e latëpermendura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk I plotëson kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë andaj është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe jot ë rekomandohet për kontratë . Duke u bazuar në deshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlërsimi dhe krahasimi i tendërve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së . Gjithashtu ju si AK nuk e keni respektuar edhe nenin 7 I LPP-së , duke na diskriminuar neve si operator ekomomik , edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD- së dhe të njoftimit për kontratë , nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi , ndërsa keni favorizuar OE e rekomanduar për kontratë

Ju si AK keni vepruar në kundërshtim edhe me nenin 6 LPP-se ku thuhet se “ Te gjitha AK , janë të obliguar të sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike të perdoren në menyre më ekonomike , njëkohesisht duke marr në konsideratë qellimin dhe lenden e prokurimit”.

Ju si AK jeni të obliguar të kurseni buxhetin e komunes ndërsa ne kete rast shum lehte keni mundur të beni nje veprim të tille duke kerkuar informacione shtese nga ne sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-se për listat që gabimisht nuk janë bashkengjitur me Dosjen e tenderit .

Gjithashtu ju si AK ju nuk e keni ne konsiderate edhe nenin 1 të LPP-se , pasi qe dihet se qellimi i ketij ligjit është të siguroje ne menyre me efikase , me transperente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike , burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve te tjera të Autoriteteve kontraktuese ne Kosove .

ARSYETIM NGA AK :

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik NR 04/L-042, I ndryshuar dhe I plotesuar me ligjin NR 05/L-068 dhe me ligjin NR 05/ L-92 Ligjit mbi prokurimit Publik ne kosov , perkatesisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rregullave për parashtrimin e kerkesave për Rishqyrtim te vendimit për eleminimin të kontrates, Zyra e Prokurimit ne Drenas nxjerrë:

VENDIM

Refuzohet kerkesa për rishqyrtim MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUESE: "RREGULLIMI I SHTRATIT TE LUMIT DRENICA DHE VERBICA".

2. Vendimi mbi refuzimin e kerkeses për rishqyrtim është I bazuar në gjendjen reale të zhvillimit të procedures se prokurimit.

Kerkesa për rishqyrtim e OE"Naser Krasniqi B.I" refuzohet si e pabazuar për arsye se nuk i ka përmbushur kerkesat e pershtatshmerise dhe kerkesat teknike/profesionale sipas Njoftim për Kontrate dhe Dosjes se Tenderit.

2. Kriteret e kerkuar nga AK ne Njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit operatori ekonomik i propozuar nga AK është i përgjegjeshem sipas kriterëve për këtë projekt, po ashtu ky operator ekonomik ka ofruar një deklarate me shkrim të nënshkruar dhe të vulosur ku qëndron me cmimin qe ka ofertuar për këtë projekt.

Pala e paknaqur me këtë vendim ka të drejte ankese në OSHP me afat prej 10 ditësh

Me Respekt!

Zyra e Prokurimit , Drenas